

VENDIM
Nr. 562, datë 31.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESIN E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja “b”, e pikës 27, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Anëtarët e huaj, në masën 600 (gjashtëqind) euro;”.

b) Pika 28 ndryshohet si më poshtë vijon:

“28. Kryetarit dhe anëtarëve, të huaj e shqiptarë, të Bordit të Akreditimit, me rezidencë të përhershme jashtë Shqipërisë, iu mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të akomodimit në Shqipëri, për jo më shumë se tri ditë kalendarike për mbledhje.”.

c) Pika 6, e shtojcës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Eksperti vendas ose i huaj, që angazhohet në kuadër të plotësimit të kushteve apo për vlerësimin paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të IAL-ve, dhe të programeve të studimit, përzgjidhet nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e miratuar nga ASCAL-i. Numri i ekspertëve duhet të jetë jo më pak se dy dhe masa e pagesës për të gjithë ekspertët të jetë jo më shumë se 25% e tarifës bazë të parashikuar për vlerësimin e jashtëm të IAL-së dhe/ose programit të studimit, sipas tabelave 2/a dhe 2/b.”.

ç) Në fund të pikës 2, të shtojcës 2, shtohen fjalitë, si më poshtë vijon:

“Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të parë të programeve profesionale të studimit, si dhe të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në IAL-të publike bëhet i grupuar, aty ku është e mundur dhe për jo më shumë se tri programe, sipas ciklit dhe fushës së studimit në nivel njësie bazë. Tarifat për vlerësimin në kuadër të akreditimit të parë të këtyre programeve të jenë sa 65% e tarifës së secilit program që do të vlerësohet i grupuar, sipas tabelës 2/b.

Në rastet kur njësi bazë ofron një program studimi profesional apo nga një program studimi për ciklin e parë dhe/ose të dytë, tarifat për vlerësimin në kuadër të akreditimit të parë të këtyre programeve të jenë sa 65% e tarifës së programit përkatës, sipas tabelës 2/b.

Ekspertët për vlerësimin e jashtëm, në kuadër të akreditimit të parë të programeve të studimit profesional, si dhe të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit në IAL-të publike, paguhet 70% të vlerës së secilit program studimi që vlerësohet i grupuar sipas tabelës 1/b.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama